



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OBILIC

Nr. Br. No. 01-104-02-33773-24

Nr. i fq. / Br. str. / No. pg. _____

Data / Datum / Date 30.10.2024

OBILIQ - OBILIĆ - OBILIC



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



KUVENDI KOMUNAL OBILIQ

Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly of Obiliq

Në mbështetje të nenit 11, 12 të paragrafit 1 dhe 2 shkronja d) neni 17 paragrafi 1 shkronja g) dhe neni 40 paragrafi 1 dhe 2 shkronja l) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008), neni 12 paragrafi 1.6 dhe neni 31 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 bazuar i Rregullores (QKRK) Nr.17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë të Tjera ndërlidhur me nenin 90 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr.04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, neni 44.1 dhe 47.3, të Statutit të Komunës nr.-I-34, të dt.25.04.2016si dhe nenin 39 të Rregullores së punës së Kuvendit, nr.-I-95, të dt.29.06.2018, Kuvendi Komunal në mbledhjen e mbajtur me dt.28.10.2024 mori këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti përfundimtar nr.16-052-01-30353-24 të dt.07.10.2024 hartuar nga Komisioni Komunal i caktuar nga Kryetari i Komunës me vendimin nr.11-1174, të dt.28.08.2023.
2. Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (DBZHR) përkatësisht Komisioni Komunal për vlerësimin e dëmeve nga breshëri, pas përfundimit të vlerësimeve ka hartuar raportin përfundimtar në të cilin ka konstatuar dëmet e shkaktuara nga breshëri në muajin Qershor të vitit 2024 për 31 fermerë në vlerën totale prej 76,992.15 euro.
3. Zbatimin e këtij Vendimi do ta bëjë Komisioni Qeveritar për vlerësimin e dëmeve.
4. Ky Vendim hyn në fuqi (15) pesëmbëdhjetë ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të MAPL-së dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

Bashkëngjitur: Raporti nr.16-052-01-30353-24 të dt.07.10.2024.

-T'i dërgohet
-Kryetarit
-Nënkryetarit
-Komisionit Qëndror Qeveritar
-Anëtarëve të KK
-MAPL
-Arkivit



Kryesuesi e Kuvendit Komunal

Vlora Mjekiçi Kabashi